



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_935_05_13**;
- Ankesa e KEK-ut e datës 31.05.2013

në seancën e mbajtur më datë 28 qershor 2013, nxorri këtë:

V E N D I M

- I REFUZOHET** ankesa e KEK-ut ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin N.M. (shifra e konsumatorit: DPR – 254) nga Prishtina ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_935_05_13 i datës 03.05.2013.

Arsyetim

Departamenti i Faturimit në KEK në muajin 01/2013 e ka faturuar konsumatorin me faturë të energjisë elektrike si faturë mujore prej 1133 kWh apo llogaritur në vlerë financiare prej 98.01€.

Pas kësaj konsumatori ka parashtruar ankesë ndaj faturës së energjisë elektrike të muajit 01/2013 për shkak të leximit jo të saktë. Pas ankesës së konsumatorit punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse me datë 14.02.2013 kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve të regjistruara në njehsorin elektrik nr. 1639013, e cila ka qenë: TL=05294 kWh (tarifa e lartë) dhe TU=30311 (tarifa e ulët).

Departamenti për Konsumator në KEK me datë 23.02.2013 i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën bazuar në pasqyrën e rrjedhës së energjisë elektrike dhe listave të leximit për periudhën 11/2012, 12/2012 dhe 01/2013.

Konsumatori pas përgjigjes së KEK-ut me datë 04.03.2013 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE. DMK pas ankesës së konsumatorit ka shqyrtimin e ankesës dhe me datë 17.04.2013 ka nxjerr vendim duke e **aprovuar** ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KEK-u që: 1) në shifrën e konsumatorit DPR – 254 ta bëjë shpërndarjen proporcionale të kilovatëve nga periudha 05/2012 e deri më 02/2013 (TL=5128 kWh dhe TU=688 kWh); dhe 2) në shifrën e konsumatorit DPR – 254 të bëjë korrigjimin në vlerë prej (-19.24€).



Pas marrjes së vendimit të DMK-së, me datë 31.05.2013 KEK-u ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së ndaj këtij vendimi, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të dispozitave ligjore.

Baza e kundërshtimeve të KEK-ut të theksuara në ankesë është procesverbali i KEK-ut të datës 14.02.2013 ku theksohet se punëtorët e KEK-ut kanë dalur për të verifikuar pikën matëse. Në ankesë po ashtu theksohet se rrjedha e energjisë nuk është provë e cila e obligon KEK-un ngas se në rastin konkret ka qenë në posedim konsumatori dhe se i njëjti ka psaur obligim ta përcjell edhe shpenzimin e harxhuar. KEK-u po ashtu thekson se shpenzimi i energjisë është bërë konform rregullores dhe tarifave të aprovuara nga ZRRE, dhe se vendimi i DMK-së është në kundërshtim me nenin 3 dhe 9 të rregullës së leximit dhe faturimit.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 28 qershor 2013 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEK-ut, përkatësisht bazën e kundërshtimit, me të cilën pretendohet se DMK, gjatë vendosjes së kësaj çështje nuk ka vlerësuar mirë provat dhe faktet e prezantuara. Bordi i ZRRE-së ka vërejtur se Departamenti i faturimit në KEK me datë 03.02.2013 e ka faturuar konsumatorin për shpenzimet mujore për periudhën 01/2013 prej 1133 kWh apo shprehur në vlerë financiare 98.01 €. Po ashtu Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe procesverbalin e KEK-ut nr. 243601 të datës 14.02.2013 të përpiluar nga punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse dhe kanë vërejtur se gjendja e shpenzimit të energjisë elektrike nr. 1639013 në momentin e inspektimit ka qenë: TL=05294 kWh dhe TU=30311 kWh.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe shpenzimin e energjisë elektrike dhe gjatë analizimit të shpenzimeve ka vërejtur se faturimi i shpenzimeve të energjisë elektrike për periudhën 11/2012, 12/2012 dhe 01/2013 është bërë bazuar në shpenzimet reale të konsumatorit të evidentuara në CCP, por po ashtu është vërejtur se nga periudha 05/2012 deri më 01/2013 i është regjistruar energjia vetëm në tarifën e lartë edhe përkundër asaj që njehsori elektrik është dy tarifor dhe shpenzimet e regjistruara në tarifën e ulët në periudhën 04/2012 kanë mbetur të pa ndryshuar deri në periudhën 02/2013 kur prapë njehsori elektrik ka regjistruar energji në tarifën e ulët, dhe se si pasojë e kësaj regjistrimi i energjisë elektrike në vetëm një tarifë ka rezultuar faturimin e konsumatorit me çmime të grupit tarifor 6. Pra gjatë analizës së bërë shpenzimit të energjisë elektrik është vërejtur se nga periudha 05/2012 deri më 01/2013 i është regjistruar energjia vetëm në tarifën e lartë edhe përkundër asaj që njehsori elektrik është dy tarifor dhe shpenzimet e regjistruara në tarifën e ulët në periudhën 04/2012 kanë mbetur të pa ndryshuar deri në periudhën 02/2013 kur prapë njehsori elektrik ka regjistruar energji në tarifën e ulët. Duke u nisur nga kjo KEK-u është dashur të merr masa që të rregulloj njehsorin elektrik ashtu që njehsori elektrik të regjistroj edhe në tarifën e ulët e jo vetëm në tarifën e lartë.

Bordi i ZRRE-së gjatë analizës së shpenzimit të energjisë elektrike konstaton se KEK është dashur që shpenzimet e regjistruara në njehsorin elektrik në muajin shkurt 2013 t'i shpërndaj proporcionalisht nga periudha 05/2012 e deri më 02/2013, pra diferencën e shpenzimit mes këtyre dy periudhave prej TL=5128 kWh dhe TU=688 kWh t'i shpërndaj proporcionalisht prej periudhës 05/2012 deri më 02/2013.

Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se KEK në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj, gjithashtu kundërshtimet të theksuara në ankesë kanë shumë kundërthënie njëra me tjetrën, andaj si të tilla nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për prishjen e këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 28.06.2013 ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK_V_935_04_13, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmimeve tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.



- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar